



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/ Ministarstvo Obrazovanja,  
Nauke i Tehnologije/ Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: OIB/301  
Datë: 01.10.2021

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), si dhe nenit 8 paragrafit 1 nënparagrafit 1.4 , shtojcës 1 pika 7 e Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 7 paragrafit 5 të Udhëzimit administrativ nr. 13/2018 Për sistemin e menaxhimit të informatave në arsimin e lartë, nxjerr:

#### V E N D I M

**Për shtyrjen e afatit të SMIAL-it për vitin akademik 2021/22, për nivelin BA dhe MA si dhe për transferin dimëror (BA, MA)**

1. Shtyhet afati i vendosjes së studentëve nga institucionet publike dhe private, në sistemin SMIAL për vitin akademik 2021/22, për nivelin BA dhe MA si dhe për transferin dimëror (BA, MA), të vitit akademik 2021/2022, si në vijim:

1.1. Afatet e parapara janë:

1.1.1. Për nivelin bachelor, afati i shtyrjes është prej datës 1 tetor deri më 31 tetor;

1.1.2. Për nivelin master, afati i shtyrjes është prej datës 10 nëntor deri më 20 nëntor;

1.1.3. Për transferin dimëror në nivelin BA dhe MA, afati i shtyrjes është prej datës 1 nëntor deri më 5 nëntor.

1.2. Afatet për dorëzimin e librave amë janë:

1.2.1. Për nivelin bachelor, afati i dorëzimit të librit amë është prej datës 1 nëntor deri më 05 nëntor;

1.2.2. Për nivelin master, afati i dorëzimit të librit amë është prej datës 21 nëntor deri më 26 nëntor.

1.2.3. Për transferin dimëror në nivelin BA dhe MA, afati i dorëzimit të librit amë është prej datës 06 nëntor deri me 11 nëntor.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### **Arsyetim**

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë, shkresën e DAL/MASHTI të dt. 30.09.2021 si dhe nevojën e shtyrjes së afatit të vendosjes së studentëve nga institucionet publike dhe private, në sistemin SMIAL për vitin akademik 2021/22, për nivelin BA dhe MA si dhe për transferin dimëror (BA, MA), të vitit akademik 2021/2022, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Vendimi u dërgohet:**

1. DAL/MASHTI;
2. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
3. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. Arkivit/MASHTI.

Arbërie Nagavci

Ministre MASHTI

